



C.nr. 1969/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i gjyqtari Zenel Leku, ne çështjen kontestimore të paditësit N.R., Rruga "...", komuna Sh., kundër të paditurës Drejtoria e Përgjithshme e Policisë- Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime Prishtinë, lidhur me çështjen juridike kontest pune, në seancën e shqyrtimit kryesor datë 19.03.2014, të mbajtur në prani të paditësit e në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit N. R., Rruga "...", komuna Sh., me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime me nr.005-KAT-2012, si shkallë e dytë, i cili vendim e ka arsyetuar Vendimin e Drejtorisë Rajonale të Ferizajit, me nr. Ref.MDNL-DRP-FE-002/2012, dhe vendimin e DRP-Ferizaj, i pranuar me datën 15.01.2012, ë anulohet vërejtja me gojë e lëshuar me datë 19.08.2011 si dhe t'i paguhen shpenzimet e procedurës, **E PABAZUAR**.

II. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë.

A r s y e t i m

Paditësi në padi ka kërkuar që të hedhet poshtë vendimi i komisionit për ankesa dhe shpërblime si i pa bazuar dhe vërejtja me shkrim të anulohet me parashtresën e datës 27.11.2013 ka kërkuar që të hidhen poshtë dhe të fshihen nga dosja e tij vendimet e për të cilat ka kërkuar që të anulohet vendimi i Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime me nr.005-KAT-2012, si shkallë e dytë, i cili vendim e ka arsyetuar Vendimin e Drejtorisë Rajonale të Ferizajit, me nr. Ref.MDNL-DRP-FE-002/2012, dhe vendimin e DRP-Ferizaj, i pranuar me datën 15.01.2012, si dhe të anulohet vërejtja me gojë e lëshuar me datën 19.08.2011, për të cilën pretendon se nuk ka qenë fare në dijeni dhe të njëjtin vendim nuk e kishte nënshkruar pasi që ishte në pushim vjetor.

Paditësi në padi parashtresë datës 27.11.2013 dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se vendimet e tilla janë të padrejta, tendencioze dhe të montuara që kanë qëllim mos avancimin e tij në pozitë në kuadër të Policisë së Kosovës. Thekson se këto vendime kanë ndikuar dhe kanë qenë vendimtare që i njëjti të ulet në pozitë apo edhe të mos pranohet në pozitë kur ka aplikuar në Departamentin e Krimeve Ekonomike, prandaj ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e tij të aprovet si e bazuar.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka vlerësuar se paditësi edhe më herët ka qenë i ndëshkuar dhe ka ra në kundërshtim me Ligjin e Policisë dhe Udhëzimin Administrativ 15.2008, shkelje të lehta disiplinore kreu i 3 neni 19- mosbindje e lehtë, pika I e nënvlerëson autoritetin mbikqyrës apo eprorit të vet dhe nga neni 19 pika 8 i cili nuk respekton me veprime apo përdor fjalë banale nga cilido mbikqyrës. Prandaj i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të refuzoj kërkesëpadinë e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin Nr.Ref MDNL-DRP-FE-004/12 dt.13.01.2012, të Drejtorisë Rajonale të Policisë si dhe Vendimin nr. 006/KA-2012 të dt. 24.02.2012 të Komisionit të Policisë për Ankesa dhe Shpërblime-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykate me 19.03.2014, bëri administrimin e provave u lexua vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme Policia e Kosovës me numer MDNL-DRP-FE-002.2012, vendimi i Drejtorisë së Përgjishme të Komisionit të Policisë për ankesa dhe shpërblime numri i lëndës 005-KAT-2012 datës 24.02.2012, raporti i policisë datës 30.03.2012, vendimi i Komisionit për ankesa dhe shpërblime me numër 006-KAT-2012 i shkallës së dytë si dhe vendimi i DRP-Ferizaj i pranuar me datën 15.01.2012, vrejttja me goje e datës 19.08.2011 – për të cilën paditësi pretendon se nuk e ka pranuar asnjëherë dhe nuk ka qenë në dijeni të ekzistimit të saj, procesverbali mbi seancën jo degjimore për shqyrtimin e ankesës së paditësit numri i rastit 006-KA-2012, raporti hetues në lidhje me lëndën 1218-PK-2011 datës 09.01.2012, njoftimi i datës 21.11.2011, raporti i Oficerit datës 23.11.2011, raporti tjetër i oficerit dt.08.01.2011 me numer terastit 1218-PK-2011, lexohet raporti tjetër në këtë rast i datës 09.01.2012, raporti i oficerit datës 23.11.2011, raporti i oficerit datës 09.01.2012, raporti i oficerit 1218-PK-2011 i datës 07.01.2012, procedimi i rastit në nivel lokal lënda me numer reference DSP/DPP/693/2011, inicimi i procedurës disiplinore numri i references DRF-DR-87/2011 datës 30.11.2011, kërkesa për fillimin e hetimeve të brendshme me numër të referencës Q.R.S.P.F.794/2011 datës 25.11.2011, formulari i paraqitjes të disiplinës së mbrendëshme i datës 25.11.2011 dhe orari ditor i patrullave.

Pas analizimit të provave secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe bindjes se lirë, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata lidhur me këtë çështje civilo juridike vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit, nga arsyet në vijim.

Rasti i parë i shqiptimit të masës disiplinore vërejtje me gojë

Ne vendimin MDNL-DRP-FE-021 datë 19.08.2011 paditësit nga komandati i stacionit policor në Ferizaj i është shqiptuar masa disiplinore vërejtja me gojë për shkak se me datën 22.04.2011 është thirre në zyrën e NJHR-së në Ferizaj në lidhje me një deklaratë vullnetare të cilën e ka dhenë me datën 11.03.2011 në njësinë NJHB dhe në intervistë para hetuesve ka thënë se “unë N. R. nuk dëshiroj që me këtë rast të merren Hetimet Rajonalre të Ferizajit dhe unë mund të deklarohej vetëm para Inspektorëve të IPK-së”. Një sjellje e tillë nga paditësi është cilësuar si shkelje e lehtë disiplinore nga neni 18.3 shkelje diskredituese dhe mosbindje nga neni 19.9 dhe 19.2 të Udhëzimin Administrativ nr.15/2008. Ku mbi këtë bazë i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me gojë.

Lidhur me shqiptimin e kësaj masa disiplinore paditësi nuk ka siguruar ndonjë provë që kundër këtij vendimi të ketë bërë ankesë në organin kompetent.

Rasti i dytë i shqiptimit të masës diciplinore vërejtje me shkrim

Nga UD Komandanti i Stacionit të Policisë në Ferizaj është iniciuar procedura disiplinore ndaj paditësit dhe kjo shkresë i është drejtuar Drejtorit rajonal të Policisë në Ferizaj, i cili lëndën e ka dërguar në procedim në Drejtorinë e Standardeve Profesionale për hetime të mëtutjeshme. Ky organ pasi që e ka hapur rastin ka vendosur që të njëjtin ta dërgoj për vendosje dhe hetime në nivel lokal . Personi kompetent, në nivel lokal, i autorizuar për të zhvilluar hetime ka përpiluar raport dhe ka ardhur në përfundim se paditësi ka ra në kundërshtim me Ligjin për Policinë dhe Udhëzimin Administrativ Nr. MPB 15/2008 shkeljet të lehta disiplinore neni 19-Mos bindje e lehte pika 1 e nënvlerëson autoritetin mbikëqyrës apo eprorin e vet dhe neni 19 pika 8- nuk respekton me veprime apo përdorë fjalë banale ndaj cilit do mbikëqyrës, për shkak se me datën 13.11.2011, rreth orës 19,45, paditësi duke punuar në detyrën e policit njoftohet nga rreshteri se me urdhër të komandantit duhet që një polic i ndërrimit tuaj së bashku me policin e sektorit në orën 22,0 të caktohen në planin operativ “Mitrovica” si zëvendësim të një polici i cili ishte i sëmurë. Ku paditësi pas marrjes së informatës ka kundërshtuar këtë urdhër dhe ka përdor fjalë fyese dhe banale në drejtim të komandantit të stacionit policor dhe nuk e ka përfillë urdhrin e eprorit. Pas këtyre hetimieve Drejtori Rajonal i Policisë në Feriazaj merr vendim me datë 31.01.2012, me të cilin paditësit për shkak të shkeljeve të lehta disiplinore i shqipton masën disiplinore vërejtje me shkrim.

Kundër këtij vendimi paditësi ka bërë ankesë dhe lidhur me këtë ankesë ka vendosur Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime me vendimin 006-KAT-2012 datës 24.02.2012, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe ka mbet në fuqi vendimi i datës 13.01.2012, me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim.

Rasti i tretë i shqiptimit të masës disiplinore vërejtje me shkrim

Duke i'u referuar ankesës së një qytetarit lidhur me sjelljet e paditësit në drejtorin rajonale të Policisë në Ferizaj janë zhvilluar hetimet preliminare në lidhje me ankesën e këtij qytetari dhe pas përfundimit të këtyre hetimeve lënda është përcjell në IPK (Inspektorati Policor i Kosovës) ku ky organ pas shqyrtimit të lëndës të njëjtën e adreson për Drejtorin e Standardeve Profesionale. DSP ka vendosur që kjo lëndë të shqyrtohet dhe të hetohet në nivel lokal dhe pas marrjes së lëndës personi kompetent në nivel lokal ka zhvilluar hetimet lidhur me rastin e paditësit dhe ka ardhur në përfundim se sjelljet e paditësit me datën 16.11.2011, duke e detyruar palën –kundërvajtësin për të shkuar në lokalet e stacionit policor dhe pritja për ti shqiptuar dënimin bien ndesh me Udhëzimin Administrativ nr.15/2008 kreu III mbi shkeljet e lehta disiplinore dhe pikës 4 të neni 20 që ka të bëjë me pakujdesin në detyrë. Pas zhvillimit të hetimeve lënda i është dërguar për të vendos Drejtorit Rajonal të Policisë në Ferizaj i cili merr vendimin 005-KAT-2012, datë 24.02.2012, me të cilin paditësit për shkak të shkeljeve të lehta disiplinore i shqipton masën disiplinore vërejtje me shkrim.

Kundër këtij vendimi paditësi ka bërë ankesë dhe lidhur me këtë ankesë ka vendos Komisioni i Policisë për Ankesa dhe Shpërblime me vendimin 005-KAT-2012 datës 24.02.2012, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit dhe ka mbet në fuqi vendimi me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore vërejtje me shkrim.

Në të tri raste në mesë të palëve ndërgjyqëse është shtruar ligjshmëria e masave disiplinore të shqiptuara me vendimet e lartshënuara.

Gjykata ka vlerësuar se e paditura me parë ka zhvilluar procedurën e brendshme disiplinore ndaj paditësit dhe pasi ka nxjerr provat e duhura ka vërtetuar se paditësi në të tri rastet ka bërë shkelje ku mbi bazën e tyre ka ardhur deri te shqiptuimi vërejtjeve të specifikuara me vendimet e lartshënuara.

Nga provat e sipër cekura si dhe nga provat tjera mbështetëse që gjinden në shkresat e lëndës, të cilat i konsideroi si më të rëndësishme për të vendosur në këtë çështje juridike, gjykata ka gjetur se vendimet anulimin e të cilëve ka kërkuar paditësi, janë të drejta dhe të ligjshme, ngase e paditura ka respektuar të gjitha procedurat e parapara ligjore dhe ka vendosur drejtë ku r ka gjetur se paditësi ka bërë shkelje të cilat bien ndesh me Udhëzimin Administrativ nr.15/2008 përkatësisht nën 20.4 dhe 19 të këtij udhëzimi dhe neneve 45, 47 dhe 49 të Ligjit për Policinë (Ligji nr.03/L-035).

Gjykata vlerëson se pala paditëse nuk ka prezentuar ndonjë provë të re me të cilën provë do të vërtetonin në procedurë gjyqësore fakte të cilat do të ishin në kundërshtim me faktet që janë provuar nga e paditura, sikundër që paditësi nuk ka prezentuar ndonjë provë të re me të cilën do të vërtetonin faktin se masat disiplinore të shqiptuar nuk janë në proporcion me shkeljet e bëra sipas parimeve të të paditurës.

Nga provat e administruara është vërtetuar se shkeljet e tilla janë kryer me të vërtetë, se shkeljet janë të rëndësishme dhe serioze dhe përbëjnë bazë të mjaftueshme për masat disiplinore të shqiptuar nga e paditura, sipas t dispozitave ligjore të lartshënuara.

Vendim për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 450 të Ligjit për Procedurës Kontestimore.

Mbi bazën e të lartshënuarave u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.1969/13 date 19.03.2014

Gjyqtari
Zenel Leku

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, Gjykate së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate